

VENDIM
Nr. 355, datë 19.4.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullore së zhvillimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “dh”, të nenit 17, shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) ndryshime që rezultojnë në ndryshimin e sipërfaqes ndërtimore të objektit, mbi tokë dhe nën tokë, brenda kufijve dhe kushteve urbane të zhvillimit, me kusht që ndryshimi i sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të mos tejkalojë masën 2% të sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të miratuar në lejen e ndërtimit.”.

2. Shkronja “sh”, e pikës 1, të nenit 19, shfuqizohet.

3. Në fund të pikës 1, të nenit 27, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Ndryshimi i sipërfaqes ndërtimore të përgjithshme, që konstatohet në përfundim të punimeve të ndërtimit të një objekti të ri, nuk konsiderohet shkelje, por marzh gabimi, në rast se nuk tejkalon masën 1% të sipërfaqes ndërtimore të përgjithshme të lejuar me lejen e ndërtimit, me kusht që ndërtimi të jetë në përputhje me kushtet e tjera urbane të zhvillimit.”.

4. Pika 7, e nenit 34, shfuqizohet.

5. Në fund të nenit 45/1 shtohet neni 45/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 45/2

Aktet e konformitetit nga KKT-ja

Për çdo aplikim për leje ndërtimi për objektet mbi 9 kate, autoritetet vendore të zhvillimit në çdo rast duhet të marrin paraprakisht aktin e konformitetit nga KKT-ja. Procedura për dhënien e aktit të konformitetit përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.”.

II. Afatet e parashikuara në rregullore llogariten në ditë pune.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi